

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE- Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Beqir Kalludra, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.L., Rr.A., G.A., N.D., I.A.dhe A.L., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Mashtrimi në votim nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I nr.90E/2013 të dt.26.06.2015, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me dt.18.09.2018, në prezencën e prokurorit të shtetit Armend Hamiti, të akuzuarve, dhe mbrojtësve të të akuzuarve G.A. dhe A.L. av.E.A. dhe av.A.T., me dt.18.09.2018 mori, dhe të njejtën ditë shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **Të akuzuarit:**

**A.L.**, i biri i N. dhe H.1, e gjinisë J., i lindur me ..., në fshatin G. e E., tani me vendbanim në L.1 rr. "B.G." nr...., ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i martuar, baba i ... fëmije, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.të letërnjoftimit ....

**Rrahim Asllani**, i biri i S.1, dhe R.1, e gjinisë A.1, i lindur me ..., në fshatin G. e U., komuna e L.2, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën normale, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike-pensioner, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.të letërnjoftimit ...

**G.A.**, i biri i A.2 dhe H.2, e gjinisë Rr., i lindur me ..., në fshatin G. e E, komuna e L.2, ku edhe tani jeton, ka të kryer studimet Bachelor, i pamartuar, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.të letërnjoftimit ...

**N.D.**, e bija e H.3 dhe M., e gjinisë N., e lindur me ..., në fshatin G. e U, tani me vendbanim në fshatin R.2, komuna e L.2, ka të kryer studimet Bachelor -pedagogji, e martuar, nënë e ... vajzave, e gjendjes së mirë ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës me nr.të letërnjoftimit ...

**I.A.**, i biri i H.4 dhe V., e gjinisë S.2, i lindur me ..., në fshatin G. e E., komuna e L.2, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.të letërnjoftimit ...

**A.L.**, i biri i R.3 dhe R.4, e gjinisë H.5, i lindur me ..., në fshatin G. e U, komuna e L.2, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike-pranues i ndihmave sociale, ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.të letërnjoftimit ....

### JANË FAJTORË

#### **Sepse:**

Me dt.12.12.2010, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës në qendrën e vendvotimit 1307E/03R, e cila gjendet në shkollën fillore "Z.H.", në fshatin G. e U.,

komuna e L.2, të pandehurit A.L., B.R., Rr.A., G.A., N.D., I.A.dhe A.L. në bashkëkryerje kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve apo votimeve në Kosovë, në atë mënyrë që me rastin e numërimit të votave të kandidatëve të subjekteve politike, kanë shtuar vota kandidatëve të preferuar, ndërsa kandidatëve të tjerë i kanë hequr gjithsej 529 vota (pesëqindenzëzetënëntë) dhe atë nga kandidatët e subjekteve politike FER, kanë heqë 1 (një) votë, AKR 133 (njëqinde tridhjetëtri) vota, PAI 4 (katër) vota, LDK 230 (dyqindetridhjetë) vota, AAK7 (shtatë) vota, PDK 11 (njëmbëdhjetë) vota.

-me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 3, 34,42, 43 lidhur me 38, 64 dhe 180 të KPK-së, si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450, 453 par.4të KPPRK-së, i:

## **G J Y K O N**

**A.L. me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**Rr.A. me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**G.A. me dënim me burgim** në kohëzgjatjen prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**N.D.me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër.

**I.A. me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

**A.L. me dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet e paushallit gjyqësor, secili veç e veç, shumën prej 30.00 (tridhjetë) euro, brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërkaq i akuzuari A.L. lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP/I nr.90E/2013 të dt.26.06.2015, kundër të akuzuarve A.L., B.R., Rr.A., G.A., N.D., I.A.dhe A.L., për shkak të dyshimit se kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale Mashtrimi në votim nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me dt.18.09.2018, kunë këtë seancë ka munguar vetëm i akuzuari B.R. dhe meqenëse gjykata nuk ka mundur ta sigurojë prezencën e të njejtit, gjykata ka marr aktvendim për veçim dhe pezullim të procedurës penale

dhe seanca ka vazhduar me të akuzuarit tjerë, të cilët pas leximit të aktakuzës e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Meqë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësojë se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pakontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarve A.L., Rr.A., G.A., N.D., I.A.dhe A.L., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Prokurori i shtetit në fund i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtorë për veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit t'i vlerësojë si rrethana lehtësuese faktin se të gjithë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për këtë veprë penale si dhe ka kaluar një kohë bukur e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale.

**I akuzuari A.L.** në fund ka deklaruar se asnjëherë më parë nuk ka qenë i akuzuar për ndonjë vepër penale, e ka pranuar fajësinë në fazën fillestare të kësaj çështje penale, ka ndier keqardhje për veprimet e ndërmarra dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do t'i përsërit veprimet e tilla të ngjajshme duke e lutur gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**I akuzuari Rr.A.** po ashtu ka deklaruar se kjo është hera e parë në jetën e tij që ka rënë ndesh me ligjin, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla, dhe se është penduar për këtë vepër penale të kryer dhe ka kërkuar nga gjykata që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**Mbrojtësi i të akuzuarit G.A. av.E.A.** në fund i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit ti vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese të propozuara nga prokuroriduke shtuar se i mbrojturi i tij për herë të parë përballet me ligjin, është i moshës relativisht të re, ka të kaluar të mirë, dhe premtonte se në të ardhmen do të silllet mirë. Andaj në kuadër të këtyre rrethanave i propozon gjykatës që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**I akuzuari G.A.deklarone** mbështetë propozimin e mbrojtësit për rrethanat e propozuara lehtësuese dhe gjithashtu kërkon nga gjykata që të njëjti t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**E akuzuara N.D.** po ashtu ka deklaruar se është hera e parë që ka qenë e akuzuar për një vepër penale, dhe e ka lutur gjykatën që bazuar në këto rrethana t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm penal.

**I akuzuari I.A.** po ashtu ka deklaruar se është hera e parë që kundër të njëjtit zhvillohet ndonjë procedurë penale, është penduar për këtë vepër, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris këto veprime të tilla a të ngjajshme duke e lutur gjykatën në fund që të njëjti t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**Mbrojtësi i të akuzuarit A.L. av.A.T. i ka propozuar** gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal kundër të mbrojturit të tij ti vlerësojë rrethanat lehtësuese dhe ate duke filluar nga e kaluara e tij kriminale, se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka kryer ndonjë vepër penale, është

i gjendjes së rëndë ekonomike, i njëjti është person me aftësi të kufizuara, andaj e lut gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

**I akuzuari A.L. deklaron:** e mbështetë fjalën e mbrojtësit të tij dhe bazuar në rrethanat lehtësuese të propozuara nga mbrojtësi e lut gjykatën që të njëjtit t'i shqiptohet një dënim sa më të butë mundshëm.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal për të akuzuarit, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, të parapara sipas nenit 64 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit, vlerësoi faktin se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sqartë, sjellja dhe qëndrimi i tyre shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i të njëjtëve për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimi i të njëjtëve se në të ardhmen nuk do të përsërisin asnjëherë këto veprime, për të akuzuarin A.L. gjykata e vlerësoi si rrethanë lehtësuese edhe gjendjen ekonomike të rëndë, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata të akuzuarve ua shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëritë plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarve, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 42 të KPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlíkueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPPRK-së, ndërkaq për të akuzuarin A.L. gjykata vendosi që të njëjtin ta liroj nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale për faktin se i njëjti jeton nga ndihma sociale dhe se pagimi i shpenzimeve të procedurës do ta rrezikonte akoma më shumë gjendjen e tij materiale si dhe të personave – anëtarëve të familjes që i njëjti është i detyruar ti mbështesë.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.368/15, dt.18.09.2018

Bashkëpunëtor profesional  
Driton Berisha

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
Beqir Kalludra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.